



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 24483 / Prot.,
R.

Tiranë, më 27/11/2015

**TË GJITHA DREJTORIVE NE DPD
DEGEVE DOGANORE**

Lënda: Njoftim Udhëzimi nr.03 datë 24.11.2015


Ju bejme me dije se është miratuar Udhëzimi i DPD Nr.3, datë 24.11.2015 "Mbi regjistrimin e kodeve në sisetmin Asycuda për markat e artikujve cigare/duhan dhe birra", një kopje të të cilit do ta gjeni bashkëlidhur kësaj shkresë.

Sqarojmë se, zbatimi i përcaktimeve të këtij Udhëzimi, nuk duhet kuptuar si veprim që përmbush kërkesat specifike, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në doganë.

Të merren masa për zbatimin me korrektesë të këtij Udhëzimi.

Pranvera FAGU (BEHUSHI)

DREJTORI PËRGJITHSHM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 24483/1 Prot.

Tiranë, më 24/11/2015

UDHËZIM

Nr. 03 datë 24/11/2015

“MBI REGJISTRIMIN E KODEVE NË SISTEMIN ASYCUDA PËR MARKAT E ARTIKUJVE CIGARE/DUHAN DHE BIRRË”

Në mbështetje të nenit 33 deri 36, 86 dhe 87 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 15 të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për Prodhimin dhe Tregtimin e Duhanit dhe të Cigareve” të ndryshuar dhe nenit 402 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor, të ndryshuar,

Me qëllim mbështetjen e vlerësimit doganor dhe mbrojtjen e interesave fiskalë në Republikën e Shqipërisë,

U D H Ë Z O J:

1. Për të evidentuar në deklaratat doganore me përshkrim të detajuar sipas emrit/markës tregtare, në sistemin informatik Asycuda bëhet regjistrimi i kodeve 11 shifrore për markat e artikujve (mallrave) cigare/duhan dhe birrë.
2. Për të kryer këtë regjistrim, në momentin e parë që kryhet një deklaratë doganore për mallrat cigare/duhan dhe birrë, Dega e Doganës përkatëse i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim një kërkesë, ku të përmenden saktësisht, emrat/markat e mallrave cigare/duhan apo birrë, si dhe nëse është e mundur cili është subjekti mbajtës i së drejtës të pronësisë intelektuale të markës për mallrat në fjalë.
3. Në rastin e importimit/eksportimit të mallit birrë, në kërkesën e operatorit ekonomik duhet të specifikohet edhe lloji i ambalazhit (kanoçe, qelq apo fuçi) dhe sasia në litra sipas llojit të ambalazhit.
4. Në rastin e importimit/eksportimit apo prodhimit vendas të mallit cigare/duhan së bashku me kërkesën e referuar në pikën 2, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe shkresën e Ministrisë së Bujqësisë (Agjencia e Duhan Cigareve) lidhur me kategorizimin e markave të reja dhe regjistrimin e markës së tyre në Regjistrin e Markave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
5. Për markat e regjistruara, para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi, operatorët ekonomik duhet të paraqesin në momentin e deklarimit në doganë, kërkesën e përmendur në pikën 2

dhe dokumentacion shtesë, me qëllim përditësimin dhe përshtatjen e regjistrimit në sistemin informatik.

6. Dega Doganore, kërkesën e operatorit ekonomik së bashku me dokumentacionin e përmendur në pikën 4, i skanon dhe më pas i dërgon në rrugë elektronike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës / Sektori i Tarifës/ e-mail s tarifa@dogana.gov.al). Kopje e dokumentacionit përcillet edhe me shkresë zyrtare.


7. Sektori i Tarifës, me të marrë informacionin nga Dega e Doganës, verifikon nëse të dhënat e referuara në pikat 2 dhe 5 janë të plota dhe më pas i dërgon në rrugë elektronike (e-mail) Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, (Sektori i Zhvillimit), tabelën me 11 shifrorin përkatës, përshkrimin e markës dhe të dhënat e tjera të taksimit (siç janë në UNTARTAB) si dhe e-mailin e Degës Doganore të referuar në pikën 6. Pas hedhjes në sistemin informatik qëndror të kodit 11 shifror, Sektori i Zhvillimit njofton në rrugë elektronike (e-mail) Degën Doganore përkatëse.

8. Regjistrimi nuk ka afat kohor por, operatorët ekonomik duhet të përditësojnë të dhënat e tyre sa herë ka ndryshime në të dhënat e paraqitura për kryerjen e këtij regjistrimi.

9. Departamenti Teknik, Departamenti i Akcizës, Departamenti Administrativ dhe Departamenti Operativo Hetimor, mbështetur në detyrat funksionale të strukturave që ato mbulojnë, duhet të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për zbatimin e këtij Udhëzimi.

10. Shtimi i regjistrimit të artikujve të tjerë, sipas përcaktimeve të këtij Udhëzimi, mund të bëhet pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, i kërkesës së strukturës doganore të interesuar së bashku me mendimin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit lidhur me ngarkesën që mundet të krijohet në sistemin informatik.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Pranvera FAGU (BEHUSHI)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

